VENDIM
Nr. 780, datë 26.12.2018

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR ULJE TË TARIFËS VJETORE TË STUDIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës, "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas kategorive të mëposhtme, paguajnë 50% të tarifës vjetore të studimeve të miratuar nga institucionet publike të arsimit të lartë:

a) Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, si dhe studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

c) Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

ç) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;

d) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore;

dh) Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;

e) Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;

ë) Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me

prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

f) Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);

g) Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.

2. Studentët sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi, paguajnë tarifën vjetore të studimeve në masën 50%, pas paraqitjes së dokumentacionit vërtetues për statusin e tyre ligjor, me vendim të Bordit të Administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë.

3. Bordi i Administrimit të institucionit shqyrton dhe miraton për çdo vit akademik, jo më vonë se muaji dhjetor, listën e studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij vendimi.

4. Vendimi i Bordit të Administrimit të institucionit publik të arsimit të lartë i njoftohet Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë rimbursohen me fonde grant nga buxheti i shtetit për vlerën e tarifës vjetore të reduktuar sa më sipër.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
ADMINISTRATORI

Tiranë, më ___/___/_____

FORMULAR APLIKIMI PËR REDUKTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT **VITI AKADEMIK 2026-2027** *Për studentët që ndjekin studimet në programet e ciklit të dyte me kohë të plotë në FAU*	**PROGRAMI I STUDIMIT:** _____
Datëlindja	
Nr. ID	
Viti i Studimit	

Unë _____, student pranë FAKULTETIT TË ARKITETKTURËS DHE URBANISTIKËS paraqes kërkesën për reduktim nga Tarifa e Shkollimit, **pasi plotësoj kushtet e përcaktuara sipas VKM nr.780, datë 26.12.2018** ***"Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë",*** duke DEKLARUAR se të dhënat e paraqitura nga ana ime si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërit prej kritereve të renditura në vijim të kërkesës, të nënvizuara me **shenjën X përbri kriterit**, janë në dijeninë time të sakta dhe janë dokumenta zyrtare të marra nga institucione shtetërore dhe/ose të njohura me ligj.

Jam në dijeni se deklarime të rreme nga ana ime në këtë kërkesë si dhe paraqitja e dokumentave të falsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht dhe heqjen e të drejtës për reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit. Dokumentat shoqëruese janë origjinale ose kopje të noterizuara sipas kërkesës.

EMËR MBIEMËR	**Nënshkrimi i studentit**

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
ADMINISTRATORI

Kriteret për përfitimin e reduktimit nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët në NEVOJË në ciklin e dytë të studimeve në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, Universiteti Politeknik, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027

Studentët në nevojë:		**1.--Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike.**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐
2. **Çertifikatë familjare nga e-albania** e tre muajve të fundit; ☐
3. **Vërtetim** nga organet e qeverisjes vendore që **familja** e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, të jetë i protokolluar ku të specifikohet numri i dosjes – dokument origjinal me firmë dhe vulë i lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore. ☐

Studentët në nevojë:		**2.—Studentët persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐
2. **Vërtetim** lëshuar nga **KMCAP** (dokument fotokopje e noterizuar); ☐
3. **Vërtetim** nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e **pagesës së aftësisë së kufizuar** – dokument origjinal lëshuar nga këto organe. ☐

Studentët në nevojë:		**3.—Studentët, të cilët kanë, të paktën njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë së Kufizuar për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐
2. **Çertifikatë familjare nga e-albania** e tre muajve të fundit; ☐
3. **Vërtetim** lëshuar nga **KMCAP** (dokument fotokopje e noterizuar), për të **paktën njërin prind**; ☐
4. **Vërtetim** nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e **pagesës së aftësisë së kufizuar** – dokument origjinal lëshuar nga këto organe . ☐

Studentët në nevojë:		**4.—Studentë deri në moshën 25 vjeç që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve.**

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
ADMINISTRATORI

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐ 2. **Çertifikatë familjare nga e-albania** e tre muajve të fundit; ☐ 3. **Çertifikatë vdekje** e prindit që nuk jeton; ☐ 4. **Vërtetim** nga organet e qeverisjes vendore që **familja** e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, të jetë i protokolluar ku të specifikohet numri i dosjes – dokument origjinal me firmë dhe vulë i lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore.; ☐ 5. **Vërtetim** nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve që **asnjë** nga familjarët e studentit (personat mbi 18 vjeç) **nuk ushtrojnë aktivitet privat**; ☐ 6. **Vërtetime nga Zyra e Punës** nëse prindi apo ndonjë pjesëtar i familjes mbi 18 vjeç janë të regjistruar si punëkërkues të papunë; ☐ 7. **Vërtetime nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore** për **familjarët** nëse **përfitojnë pension ose jo** ; ☐ 8. **Vërtetime** nëse familjarët kanë tokë ose pasuri të paluajtëshme fitimprurëse në pronësi ; ☐		
Studentët në nevojë:		**5.—Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.**
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐ 2. **Fotokopje e noterizuar** e dokumentit për **statusin e jetimit**; ☐ 3. **Çertifikatë familjare nga e-albania** e tre muajve të fundit; ☐ 4. **Çertifikatë vdekje** për të **dy prindërit**. ☐		
Studentët në nevojë:		**6.—Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me Vendim Gjykate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç.**
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm: 1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐ 2. **Çertifikatë familjare nga e-albania** e tre muajve të fundit; ☐ 3. **Fotokopje e noterizuar e Vendimit** të Gjykatës së formës së prerë. ☐		
Studentët në nevojë:		**7. —Studentët që janë identifikuar si viktima të trafikut të qënieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qënieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç.**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐
2. **Çertifikatë familjare nga e-albania** e tre muajve të fundit; ☐
3. **Dokument Vërtetues** lëshuar nga organet përkatëse, për studentët që kanë përfituar **statusin ligjor si viktima** të trafikut të qënieve njerëzore- Dokument origjinal ose fotokopje e noterizuar. ☐

Studentët në nevojë:		**8. —Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐
2. **Çertifikatë familjare nga e-albania** e tre muajve të fundit; ☐
3. **Çertifikatë vdekje** për njërin prind; ☐
4. **Vërtetim** të lëshuar nga Institucioni përkatës i **humbjes së jetës së prindit** në krye dhe për shkak të detyrës – Dokument origjinal ose fotokopje e noterizuar. ☐

Studentët në nevojë:		**9.—Studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit.**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐
2. **Vetëdeklarim noterial i studentit;** ☐

Studentët në nevojë:		**10. —Studentët, fëmijë të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.**

REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS
ADMINISTRATORI

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të **kartës** së ID të studentit; ☐
2. **Çertifikatë familjare nga e-albania** e tre muajve të fundit që vërteton lidhjen e studentit me prindin ish të dënuar dhe të përndjekur politik nga sistemi komunist ose fëmijë me prind të dënuar politik me heqje lirie; ☐
3. **Vërtetim i statusit të prindit** ish të përndjekur/dënuar politik – Dokument origjinal; ☐
4. **Dëshmi penaliteti** për prindin ish të përndjekur politik ose **Vërtetim** për kohën e dënimit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Dokument origjinal; ☐

Nuk përfitojnë reduktim nga tarifa e shkollimit, studentët që janë duke ndjekur një **program të Dytë Studimi** dhe **studentët** të cilët në vitin akademik 2026-2027 **janë studentë përsëritës**.

Emër Mbiemër Nënshkrim i studentit **Nr.Telefoni**

_____ _____

Mori në shqyrtim paraprak specialisti i Zyrës së Financës pranë FAU_____